



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 463/02-11157
Dt: 18.07.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, duke vepruar konform dispozitave të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nenit 11 të Kontratës me numër 01-463/02-25848, me datën 18.07.2024, merr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa për shkëputjen e Kontratës për shfrytëzimin afatshkurtër të pronës komunale – Kioskun, e lidhur ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe përfaqësuesit të biznesit “Egzon Syla” B.I nga Gjakova, me numër 01-463/02-25848, e datës 01.11.2020.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës dhe z. Egzon Syla, përfaqësues i biznesit “Egzon Syla” B.I nga Gjakova kanë lidhur Kontratë me numër 01-463/02-25848, e datës 01.11.2020, për shfrytëzimin afatshkurtër të pronës komunale – Kioskun, me kohëzgjatje nga data 02.11.2020 deri me datë 02.11.2025.

Përfaqësuesi i biznesit “Egzon Syla” B.I, me kërkesë me numër 01-353/01-10541 të datës 09.07.2024, ka kërkuar nga Komuna e Gjakovës që të bëjë shkëputjen e kontratës për shkak se ka ndryshuar lokacionin dhe e njëjta pronë nuk i nevojitet për të ushtruar aktivitetin e tij.

Andaj, në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nenit 11 të Kontratës me numër 01-463/02-25848 të datë 01.11.2020, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ me padi në Gjykatën kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë Inspektuese
- Palës
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës